



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

Vendim

Nr. 40 Date 22/09/ 2017

Për

Dhënien e mendimit për përdorim të rezervës ujore për energji elektrike për HEC “Mallunxa” nga subjekti “Nord Energji” shpk, Perroi i Zallit degë e Perroit te Ljuses, në Bashkinë Mat, Qarku Dibër.

- Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 51 dhe nenit 52 të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujore”, nenit 24 të Vendimit të KM nr. 822, date 07.10.2015, “Per miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”(i ndryshuar), me propozim të A.B.U. Mat, **Këshilli i Basenit Ujor Mat**,

Vendosi:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “**Nord Energji**” shpk me Administrator Z.Jani Saliq, për “Përdorim Rezerva Ujore për Energji Elektrike” sipas studimit të paraqitur nga subjekti “**Nord Energji**” shpk, me këto të dhëna:

HEC “Mallunxa”,

Subjektit juridik/fizik :“ Nord Energji ” shpk

- Perroi i Zallit degë e Perroit të Ljuses, degë e Lumit Mat në Bashkinë Mat, Qarku Dibër.
- Prurja mesatare : $Q= 1.85$ m³/sek,
- Prurja llogarites: $Q= 2.4$ m³/sek,
- Prurja ekologjike: $Q= 0.17$ m³/sek,
- Prurje per perdorime te tjera: 0.006 m³
- Kuota e vepres se marrjes Z 340 m, X-44 24 663 Y-46 09 613
- Kuata e godies se centralit: Z 252m. X- 44 23 009 Y-46 07 418
- Energjia e planifikuar vjetore: 6 664 038.0 kwh/vit,
- Fuqia 1 580 kw,ore pune/vit 4124

2- Nuk lejohet ndryshimi i regjimit të vaditjes,i furnizimit me ujë të popullatës etjere nga përdorimi i ujit për energji elektrike.

3. Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËSI I A.B.U. MAT
Ast **NIKOLLA**



KRYETARI I K.B.U. MAT
Eduard **NDRECA**

